



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më ____/____/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Karburanti Gazoil D1 dhe Benzinë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

10,963,000 (dhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier”Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për **xhiron vjetore** për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, **duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës (vlera e fondit limit)**”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 i LPP, si dhenen 43 pika 2, gërma “b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës dhe i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, argumentohet si vijon: Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të **balanceve për vitet (2022, 2023, 2024)**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Kërkesa për paraqitjen e balanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një **vërtetim për shlyerjen e taksave vendore** të parashikuara nga Pushteti Vendor **për vitin 2024, 2025** ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024, 2025 pranë bashkisë/vendit ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të i identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

➤ 2.3 KAPACITETI TEKNIK:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2022-2023-2024) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**, të realizuar gjatë ketyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/gërma“c” të Ligjit nr.162, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Fletë analize ose Vërtetim teknik** nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) të akredituara në fushën e çertifikimit dhe inspektimit teknik të linjave teknologjike në fushën hidrokarbure, e lëshuar jo më herët se **6 (gjashtë) muaj** nga data e hapjes së tenderit.

Arsyetimi: Bazuar në VKM nr.491 datë 19.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”; ligjin Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin, dhe tregëtimin e gazoil D1, benzinës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar); VKM nr.970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”; në Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020 “Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 4; VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 40 pika 6/”c”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të sigurojë **furnizim të pandërprerë 24 orë** në çdo ditë të javës në çdo pikë furnizimi. Në lidhje me këtë pikë ofertuesi të paraqesë një deklaratë që është dakort për këtë mënyrë furnizimi. Operatori ekonomik duhet të sigurojë karburant në çdo kohë sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Arsyetimi: Pika 2.3.3 është vendosur në përputhje me Ligjin Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin, dhe tregëtimin e gazoil D1, benzinës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”(i ndryshuar), në Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 1/”c”. Specifikimet janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të këtë në pronësi ose me qera së **paku një pikë furnizimi brenda territorit të qytetit Fier dhe dy stacione karburanti në Qarkun e Fierit**, vërtetuar kjo me çertifikatë pronësie, kontratë qeraje apo kontratë bashkëpunimi me pika furnizimi në qytetet e tjera, të lidhura para noterit, me afat vlefshmërie për të gjithë periudhën e ekzekutimit të kontratës për këtë objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Stacionet e furnizimit me karburant të kenë të njëjtën logo të vërtetuar me një deklaratë nga subjekti.

2.3.5 Lëvrimi i karburanteve do të bëhet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, sipas sasive dhe specifikimeve teknike të dhëna në Dokumentat Standarte të Tenderit, gjithashtu ofertuesi duhet të paraqesë dokumenta apo deklaratë që mund **të furnizojë karburant me kartë elektronike** të personalizuar, me targën e cdo automjeti të Autoritetit Kontraktor, sipas kërkesave të AK, bazuar në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Ofertuesi duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.

1. Operatori ekonomik fitues bazuar në “VKM nr.561 datë 29/07/2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe në njoftimin nr.2123 datë 31.01.2017 të APP, në përfundim të procedurave të prokurimit do të marrë një listë të mjeteve efektive të transportit me qëllim pajisjen e tyre me kartë elektronike të personalizuar.
2. Shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet e transportit do të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

Arsyetimi: Pikat 2.3.4 dhe 2.3.5, janë vendosur në përputhje me Ligjin Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin, dhe tregëtimin e gazoil D1, benzinës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”(i ndryshuar); Ligjin nr.118/2012 dt.13.12.2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshëm ”.

❖ SPECIFIKIMET TEKNIKE

Kujdes- Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj., Specifikimi i Materialeve, Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to :

Të dhënat teknike të Gazoil D1 (Eurodizel) i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH):

GAZOIL D1 10ppm
Karburant dizel (Gazoil) sipas [SSH EN 590:2022](#)
Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Kufijt		Metoda e testimit
		minimum	maksimum	
Numri i cetanit *		51,0	-	Ne perputhje me EN ISO 5165 EN 15195:2014 EN 16715:2015 EN 16906:2017 c EN 17155:2018
Indeksi i cetanit		46,0	-	EN ISO 4264 ASTM D 976
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 ASTM D 4052
Hidrokarburët aromatikë policiklikë*	% (m/m)	-	8,0	EN 12916:2019
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846:2019 e EN ISO 20884:2019 EN ISO 13032:2012
Përmbajtja e manganit	mg/l		2,0	EN 16576:2014
Karboni i pikës së ndezjes	°C	Mbi 55,0		EN ISO 2719
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719

Mbetja e karbonit 8 (në 10 % mbetje distilimi)*	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit*	% (m/m)	-	0,010	EN 6245
Permbajtja e ujit	Mg/Kg	-	200	EN ISO 12937
Ndotje totale	mg/kg		24	EN 12662
Pika e bllokimit të filtrit në të ftohtë CFPP *	*C	-	-	EN 116
Korrozioni në shufër të bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e metil esterit të acidit yndyror (FAME)	% v/v	-	7,0	EN 14078:2014
Stabiliteti i oksidimit 1	g/m3		25	EN ISO 12205
Stabiliteti i oksidimit për karburantin dizel që përmban FAME mbi 2,0 % (V/V)'	Orë ose min	20,0 or 60,00		EN 15751 ose EN 16091
Lubriciteti, diametri i mbresë së veshjes (WSD) në 60°C	pm		460	EN ISO 12156-1 i
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,000	4,500	EN ISO 3104k ISO 23581
Distilimi : - Destilati që vlon deri në 250 grade C,% (v/v) - Destilati që vlon deri 350 grade C, ne % (v/v) - 95 % (v/v) destilon në	% (V/V) % v/v O. C	- 85 -	<65 - 360	EN ISO 3405:2019 n EN ISO 3924:2019 EN 17306:2019 c

FAME do të plotësojë kërkesat e EN 14214:2014+A2:2019, shih [3]. 1 Kërkesa për stabilitetin e oksidimit duke përdorur EN ISO 12205 zbatohet për të gjitha karburantet me naftë, pavarësisht nga përmbajtja FAME. Për karburantin dizel që përmban FAME mbi 2,0 % (V/V), ekziston një kërkesë shtesë për të testuar qëndrueshmërinë e oksidimit duke përdorur ose EN 15751 ose EN 16091. Shih gjithashtu 6.7.9. i Lubriciteti i një karburanti dizel, pavarësisht nga përmbajtja e tij FAME, duhet të përmbushë kufirin HFRR prej maksimumi 460 pm.

Karburanti dizel me një përmbajtje FAME që kalon 4,0 % (F/iq në përgjithësi ka lubrifikim të mirë me HFRR nën 460 pm dhe nuk kërkon domosdoshmërisht një test HFRR për sa kohë që nuk dihet ndonjë përvojë negative. k Shih gjithashtu 6.7.8. 1 Për llogaritjen e indeksit të cetanit nevojiten gjithashtu pikat e rikuperimit 10 %, 50 % dhe 90 % (V/V). m Kufijtë për distilimin në 250 °C dhe 350 °C janë përfshirë për karburantin dizel në përputhje me tarifën e përbashkët doganore të BE-së. n EN ISO 3924:2019 jep udhëzime për të kthyer në të dhëna ekuivalente me ISO 3405. Shih gjithashtu 6.7.5.

BENZINË SUPER PA PLUMB

Të dhënat teknike të benzinës pa plumb i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH):

Karburant Benzinë pa plumb sipas **S SH EN 228:2012** ose **S SH EN 228:2012+A1:2017**
ose të përditësuarat e tyre **SSH EN 228:2022**

Kërkesat të përgjithshme dhe metodat e provës për benzinën super pa plumb

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Norma e lejuar		Metoda e provës ^a (Shih pika 2 Rekomandime të detyrueshme)
		Minimal ë	Maksimalë	
Numri i oktanit kërkimor, NOK		95,0	-	prEN ISO 5164 ^b
Përmbajtja e plumbit	mg/l	-	5	prEN 237
Densiteti (në 15 °C) ^c	kg/m ³	720	775	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Përmbajtja e squfurit ^c	mg/kg	-	10.0 (nga 01.01.2009)	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Stabiliteti ndaj oksidimit	minuta	360	-	EN ISO 7536
Përmbajtja e rrëshirave faktike (të lara në tretës)	mg/100 ml	-	5	EN ISO 6246
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50°C)	renditje	klasa 1		EN ISO 2160
Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme		Pamje vizuale
Përmbajtja e tipit të hidrokarburit	% (V/V)			ASTM D 1319 ^{d, e, f} prEN 14517
- olefinat ^c - aromatiket ^c		- - -	18,0 42,0 (deri në 31.12.2004) ose 35,0	
Përmbajtja e benzenit ^c	% (V/V)	-	1,00	EN 12177 EN 238 prEN 14517
Përmbajtja e oksigjenit ^c	% (m/m)	-	2,7	EN 1601 EN 13132

Përmbajtja e komponimeve oksigjenore ^c	% (V/V)			EN 1601:1997 prEN 13132:1998
- methanol (alkool metilik) g		-	3	
- etanol (alkool etilik) h		-	5	
- alkool iso-propilik		-	10	
- alkool iso-butilik		-	10	
- alkool terc-butil		-	7	
- etere (me 5 ose më shumë atome C)		-	15	
- komponime oksigjenore të tjera i		-	8	

Shënim: Vlerësimi i Kapacitetit teknik dhe hartimi i specifikimeve teknike është kryer sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, duke u shoqëruar me dokumentat të cilat vërtetojnë se operatori ekonomik ka eksperiencë në këtë prokurim dhe mallrat që do të prokurohen i përmbushin standartet teknike, kjo për shkak të rëndësisë së veçantë që ka ky prokurim.

Këto specifikime mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe nuk shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurim, **neni 2 pika “d” i Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”**(i ndryshuar).

➤ **Afatet e lëvrimit:**

12 MUAJ NGA MOMENTI I NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS

- **Kartat e karburanteve** do të merren me paraqitjen e kërkesës me shkrim nga ana e Autoritetit Kontraktor gjithashtu edhe kartat e personalizuar me targën e automjeteve të AK.
- Koha e furnizimit do të jetë cdo ditë për 24 orë pa ndërprerje, **me paraqitjen e kartave të lëshuara nga Kontraktuesi**, në secilën nga pikat e shpërndarjes së karburanteve të deklaruar prej tij në ofertë

➤ **Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr.	Lloji i karburantit	Njësia	Sasia/vit
1	Gazoil D1	litra	71,000
2	Benzinë pa plumb	litra	5,000

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____ 2. _____ 3. _____